REPUBLIKA E SHQIPERISE
KËSHILLI BASHKIAK
LUSHNJE

Nr.8168/1 Prot.

Lushnje, 18/09/2025

PROJEKT - VENDIM
Nr. 85 Datë 18/09/2025

PËR NDRYSHIM TË VENDIMIT NR. 75 DATË 23/07/2025 MBI "MIRATIMIN E PROJEKTIT NDËRKOMBËTAR "ENFORSA – FORCIMI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE PARANDALIMIT TË ZJARREVE PËRMES TEKNOLOGJIVE TË AVANCUARA DHE MASAVE TË ZBATUARA NË ZONAT NDËRKUFITARE"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___/___/2025, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Integrimit, Politikave Sociale dhe Informimit "Për Regjistrimin dhe Zbatimin e **Projektit Ndërkombëtar ENFORSA," mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, neni 54, gërma n "Për vetëqeverisjen vendore"; Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008, nenet 6 dhe 15 "Për menaxhimin e** sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"; Ligjin Nr. 68/2017, neni 6, gërma a, dhe neni 10 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; Ligjin Nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025"; Ligjin Nr. 43/2016 "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë"; VKM Nr. 775, pika 5, pika 13, pika 21, datë 24.09.2010 "Për administrimin e financimeve të huaja"; dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 10, datë 12.07.2024,

VENDOSI:

1. Të miratohet zbatimi i projektit ENFORSA: Enhancing forest management and fire risk prevention through advanced spatial analysis and applied measures in the cross-border area", siç është miratuar nga Komiteti i Menaxhimit (MC).

2. **Të ardhurat e Bashkisë për periudhën 2025–2027 të shtohen me vlerën prej €400,249.00** (39,272,431.88 ALL), për zbatimin e projektit.

3. Buxheti i ndarë sipas kategorive (01 Shtator 2025 – 01 Shtator 2027) përcaktohet si më poshtë:

Kategoria	Shuma (€)
Kosto Personeli	21,230.00
Kosto zyre dhe administrimi	3,184.50
Kosto udhëtimi dhe akomodimi	3,184.50
Ekspertiza dhe Shërbime të Jashtme	55,650.00
Pajisje	317,000.00

Totali: €400,249.00 (për Bashkinë e Lushnjes, sipas Formularit të Aplikimit të miratuar).

4. Të autorizohet Kryetarja e Bashkisë Lushnjë, znj. Eriselda Sefa, të nënshkruajë çdo dokument të nevojshëm lidhur me zbatimin e këtij projekti.
5. Të konfirmohet që Bashkia Lushnje, si Përfitues, është në përputhje me nenin 65 të Rregullores (BE) 1060/2021 për sa i përket operacioneve të infrastrukturës dhe investimeve.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Integrimit, Politikave Sociale dhe Informimit dhe Drejtoria e Buxhet-Financë.

7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Drejtoria e Përgjithshme e Integrimit,
Politikave Sociale dhe Informimit
Ariola Korreshi

Drejtoria Juridike
Bedri Hida

KRYETARI I BASHKISË
Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIALUSHNJE

Nr.8169 Prot.

Lushnje, më 19/09/2025

RELACION
PËR NË KËSHILLIN BASHKIAK

"PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT NR. 75, DATË 23.07.2025 "PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT NDËRKOMBËTAR ENFORSA – FORCIMI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE PARANDALIMIT TË ZJARREVE PËRMES TEKNOLOGJIVE TË AVANCUARA DHE MASAVE TË ZBATUARA NË ZONAT NDËRKUFITARE"

Në mbledhjen e datës 23.07.2025, Këshilli Bashkiak miratoi vendimin nr. 75 mbi regjistrimin dhe miratimin e projektit ndërkombëtar **ENFORSA**, me vlerë totale **€400,249.00 (39,272,431.88 ALL)** për periudhën 2025–2027.

Gjatë procesit të rakordimit me Autoritetin e Menaxhimit dhe Komitetin e Menaxhimit të Programit, ndarja e buxhetit sipas kategorive, të përputhet me Formularin e Aplikimit të miratuar nga programi.

Për këtë arsye, është e nevojshme ndryshimi i vendimit ekzistues, duke reflektuar:

- Emërtimin e plotë të projektit në gjuhën angleze sipas dokumentacionit zyrtar siç është miratuar nga Komiteti i Menaxhimit (MC);

ENFORSA – Forcimi i Menaxhimit të Pyjeve dhe Parandalimit të Zjarreve Përmes Teknologjive të Avancuara dhe Masave të Zbatuara në Zonat Ndërkufitare,

ENFORSA – Enhancing Forest Management and Fire Risk Prevention through Advanced Spatial Analysis and Applied Measures in the Cross-Border Area.

- Shumat sipas kategorive të miratuara nga programi:

Kategoria	Shuma (€)
Kosto Personeli	21,230.00
Kosto zyre dhe administrimi	3,184.50
Kosto udhëtimi dhe akomodimi	3,184.50
Ekspertiza dhe shërbime të jashtme	55,650.00
Pajisje	317,000.00
Totali	**400,249.00**

Adresa: Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel: +355 35 222139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

Gjithashtu, me vendimin e ri duhet të autorizohet Kryetarja e Bashkisë Lushnje për nënshkrimin e dokumenteve të zbatimit dhe konfirmimin e përputhshmërisë së Bashkisë Lushnje me rregullat e BE-së.
Ndryshimi i vendimit është një **proces teknik dhe i domosdoshëm** për të garantuar zbatimin korrekt të projektit dhe përputhshmërinë me legjislacionin shqiptar dhe rregullat e financimeve të BE-së.

Për këto arsye, i propozohet Këshillit Bashkiak miratimi i projekt-vendimit "Për ndryshimin e Vendimit nr. 75, datë 23.07.2025".

DREJTORIA E PËRGJITHME E INTEGRIMIT, POLITIKAVE SOCIALE DHE INFORMIMIT

Ariola Korreshi

Adresa: Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel: +355 35 222139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com